

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
NR. 2088 REP
NR. 692 KOL



Taksa e Pulles
U PAGUA

KONTRATË

PËR SHIT-BLERJEN E KUOTAVE

Sot më datë 04 mars 2019 (dy mijë e nëntëmbëdhjetë), para meje Noterit Julian Zhelegu, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, me seli në Rrugën "Pjetër Bogdani", nr. 13, kati 1, u paraqiten:

PALËT:

1. **Z.Shkëlqim Llagaçi**, i biri i Ismailit, lindur në Peshkopi, Diber, më datë 09.05.1976, banues në Kamze, Tiranë, person madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së Pasaportës me nr. BR8764780, në cilësinë e ortakut të vetëm dhe zotërueshit të 100 % të kuotës së Shoqërisë "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k, me nr. NUISL72412038S, subjekt i së drejtës shqiptare, regjistruar si person juridik pranë Regjistrat Tregtar të Qendrës Kombëtare të Bizneseve; që do të quhet në këtë kontratë **Shitësi (pala e parë)**

Dhe

2. **Shoqëria "Bindi" sh.p.k**, person juridik i të drejtës Shqiptare, me Nr. NIPT J71630001K, me administrator Z. Hysen Ruka, me seli në Rrugë "Vaso Pasha", Ndërtesa Nr. 8, K. 4, Ap. 10, Tiranë; që do të quhet në këtë kontratë **Blerësi (pala e dyte)**

Palët ranë dakort për hartimin dhe nënshkrimin e kontratës së shit-blerjes së 51% të kuotës në pronësi të ortakut të vetëm Z.Shkëlqim Llagaçi në Shoqërinë "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k. mbështetur në premisat :

- **Shoqëria "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k**, me nr. NIPT L72412038S, është një shoqëri e së drejtës shqiptare, regjistruar si person juridik ne Regjistrin Tregtar të Bizneseve pranë Qendrës Kombëtare të Bizneseve, me seli në adresën: Bërxull Ruga Dytësore Tiranë-Vorë, Km.13, ish Fabrika e Inerteve, përfaqësuar ligjërisht nga Z. Shkëlqim Llagaçi, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i



pasaportës me nr. BR8764780. Shoqëria ka një kapital të regjistruar, nënshkruar dhe derdhur, në vlerën 1.000.000,00 lekë, i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale të një kuote prej 1.000.000,00 lek, të zotëruar në masën:

100% nga ortaku Z. Shkëlqim Llagaçi, i biri i Ismailit, lindur në Peshkopi, Diber, më datë 09.05.1976, banues në Kamze, Tiranë, person madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së Pasaportës me nr. BR8764780

- Shitësi në këtë kontratë, Z. Shkëlqim Llagaçi, ka vendosur që 51% të kuotës së vetme, zotëruar prej tij në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k. ta shesë tek blerësi Shoqëria "Bindi" sh.p.k.
- Blerësi në këtë kontratë, Shoqëria "Bindi" sh.p.k, është ofruar për blerjen e 51% të kuotës në pronësi të shitësit Z. Shkëlqim Llagaçi në kapitalin e regjistruar të "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k.

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATËS

1.1 Objekt i kësaj kontrate është transferimi i pronësisë nga Shitësi tek Blerësi, sipas kushteve dhe termave të përcaktuara nëpërmjet kësaj kontrate, të :

- 51% të kuotës së ortakut Z. Shkëlqim Llagaçi, e barazvlefshme në vlerë kapitali në shumën prej 510.000,00 lekë ;
- ç'do të drejte që i përket kësaj përqindje, të lirë nga çdo barrë apo pretendim, për një vlerë të barabartë me shumën e përcaktuar në nenin 2.

1.3 Transferimi i pronësisë mbi kuotën parashikuar në këtë Kontratë do të kryhet në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate dhe vetëm duke u shoqëruar me mandatin e likujdimit të vlerës së plotë të rënë dakort mes palëve, ne nemim 2.1 te Kontrates.

NENI 2

ÇMIMI I BLERJES DHE METODA E PAGESËS

2.1 Çmimi i blerjes për 51% të kuotës është 130.000 Euro.

2.2 Çmimi i kësaj kontrate do të paguhet sipas kushteve dhe afateve që më poshtë vijojnë:

- Brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate Shitësi do të detajojë astetet e Shoqërisë "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k si dhe do të listojë në mënyrë analitike asetet dhe komponentët (të shoqëruara me numrat serial përkatës) e përfituarë sipas faturës tatimore të shitjes me nr. Serial 34100450, me Nr. Fature 50, datë 02.04.2018, lidhur midis Shoqërisë "Autochtonous" sh.p.k në cilësinë e Shitësit dhe Shoqërisë Shoqërisë "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k në cilësinë e Blerësit.



- Me përbushjen e kushtit të mësipërm, Blerësi do të paguajë çmimin e blerjes në llogarinë bankare të Shitësit si më poshtë:
 - o Emri i bankës: Raiffeisen Bank
 - o Emri i llogarisë: Shkelqim LLAGACI
 - o Numër llogarie: 0003450477
 - o IBAN : AL6120259000000000003450477

NENI 3

DETYRIMET E PALËVE NË LIDHJE ME TRANSFERIMIN

Për transferimin e pronësisë së 51% të kuotës sipas kësaj kontrate:

a) *Shitësi do të:*

- i. Dorëzojë gjithë dokumentacionin ligjor, ekonomik – finanziar dhe teknik të shoqërisë në datën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.
- ii. Do të realizojë të gjitha ndryshimet përkatëse të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar, si dhe në të gjitha institucionet dhe regjistrat përkatës ku shoqërisë i lind detyrimi të pasqyrojë ndryshimet që rrjedhin nga kjo kontratë.

Dhe

b) *Blerësi do të:*

- i. Paguajë të plotë çmimin e Blerjes në shumën e caktuar në nenin 2 të kësaj kontrate, sipas modaliteteve të përcaktuara në nenin e sipërpërmendur.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, ortakët respektivë të Shoqërisë "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k do të janë: (i) Shkëlqim Llagaçi, i cili do të zoterojë 1 kuotë, e barazvlefshme me 49% te pjesemarrjes, e barazvlefshme në vlerë kapitali në shumën prej 490.000,00 Lekë si dhe Shoqëria "Bindi" sh.p.k, e cila do të zoterojë 1 kuotë, e barazvlefshme me 51% te pjesemarrjes, e barazvlefshme në vlerë kapitali në shumën prej 510.000,00 Lekë. Secila nga palët autorizohet për të aplikuar në QKB për ndryshimet përkatëse, rezultat i nënshkrimit të kësaj kontrate.

Blerësi do të fitojë titullin e pronësisë mbi kuotën në momentin e likuidimit të detyrit që lind pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe do të gëzojë të gjitha të drejtat e tjera që lidhet me të.

NENI 4

DEKLARIMET DHE GARANCITË E SHITËSIT

RL
JULI 3

4.1 Deklaratat dhe Garancitë e Shitësit në Datën e Nënshkrimit të marrëveshjes, janë si vijon:

4.1.1 Mbarëvajtja

Shoqëria "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas Legjislacionit në Republikën e Shqipërisë. Ajo është e organizuar rregullisht, ekziston në mënyrë të vlefshme dhe konsiderohet në mbarëvajtje sipas Legjislacionit në Republikën e Shqipërisë.

4.1.2 Kuota e lirë nga çdo barrë

Kuota është nënshkruar rregullisht, është paguar plotësisht si dhe është e lirë dhe e çliruar nga çdo Barrë apo pretendim i të tretëve. Transferimi i pronësisë mbi Kuotën nuk i nënshtronhet ndonjë kufizimi sipas dokumenteve statutorë të "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k apo ndonjë marrëveshje me palë të treta, ose ligji, rregullore, vendimi përfundimtar, urdhri apo vendimi të ndërmjetëm gjyqësor, dhe kjo Marrëveshje përbën për Shitësin detyrime ligjore të vlefshme dhe të zbatueshme.

4.1.3 Tatimet dhe Taksat

Shitësi deklaron se Shoqëria "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k ka depozitar, në përputhje me normat përkatëse, të gjitha deklaratat e kërkuara nga Legjislacioni Tatimor, doganor dhe ai për sigurimet shoqërore, depozitimi i të cilave duhej bërë përpara datës së kësaj marrëveshjeje dhe përbajtja e tyre është e saktë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Shoqëria "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k ka paguar rregullisht dhe brenda afateve përkatëse të gjitha Tatimet dhe Taksat që duhen vlerësuar apo paguar.

Shoqëria "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k ka bërë të gjitha zbritjet dhe ndalesat në burim nga të gjitha pagesat kryesore të bëra prej saj, në mënyrën dhe shumat e duhura për efekt apo për llogari të çdo Tatimi apo Takse. Shoqëria "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k i ka raportuar Autoritetit Tatimor të gjitha shumat e zbritura apo të mbajtura në burim në përputhje me ligjin.

Në rast se Shoqëria "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k do të rezultojë me detyrime tatimore apo financiare të një periudhe përpara datës së nënshkrimit të kësaj kontrate, përgjegjës në raport me Shoqërinë, organet shtetërore apo persona të tjerë të tretë do të jetë vetëm Shitësi.

4.1.4 Të tjera

Shitësi deklaron në cilësinë e aksionerit të vetëm të Shoqërisë "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k se garanton Blerësin nga çdo pretendim i personave të tretë resultat i veprime juridike (marrëdhënieve në të cilat Shoqëria ka qenë palë) të një date të mëparshme nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate. Po ashtu, për çdo dëm që do ti shaktohet Shoqërisë "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k nga persona të tretë si resultat i marrëdhënieve në të cilat Shoqëria ka qenë palë përpara datës së nënshkrimit të kësaj kontrate, përgjegjës si



në rapport me Shoqerinë "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k ashtu edhe në rapport me personat e tretë do të jetë vetëm Shitësi.

Shitësi deklaron se asete të shoqërisë "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k janë ato që do të detajohen në përputhje me nenin 2.2 të kësaj kontrate. Nëse pas nënshkrimit të kontratës asetet e Shoqërisë do të pakësohen si rezultat i veprimeve juridike (në të cilat Shoqëria ka qenë palë) të një date të mëparshme nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate, atëhere, Blerësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kësaj kontrate dhe kthimin e çmimit të paguar.

NENI 5 **DEKLARIMET DHE GARANCITË E BLERËSIT**

Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin si më poshtë:

a. Blerësi ka:

- (i) kompetencat dhe autoritetin për të kerkuar dhe vepruar sipas kësaj kontrate dhe çdo dokumenti tjeter që duhet të ekzekutohet në lidhje me të;
- (ii) të drejtë për të marrë dhe qarkulluar të gjitha autorizimet dhe njoftimet që kerkohen me ligj për ekzekutimin e kësaj kontrate;
- (iii) Kjo kontratë dhe të gjithë dokumentet e tjerë që duhet të ekzekutohen në lidhje me të dhe në të cilat Blerësi është palë, krijojnë aktualisht apo në të ardhmen, në momentin që ekzekutohen, detyrime të vlefshme të Blerësit, sipas kushteve përkatëse.

b. Nuk kerkohet asnjë leje, miratim, autorizim, apo deklarim, depozitim ose regjistrim, nga asnjë autoritet qeveritar apo rregulator, nga dhe në emër të Blerësit, në lidhje me lidhjen, zbatimin, përfundimin e kësaj Kontrate nga Blerësi, apo përbushjen nga Blerësi të detyrimeve të miratuara këtu.

Zbatimi dhe përfundimi i kësaj Kontrate nga ana e Blerësit dhe përbushja e detyrimeve të miratuara këtu:

- i. nuk do të cënojë asnjë klauzolë ligjore të legjislacionit të zbatueshëm në fuqi;
- ii. nuk do të kërkojë ndonjë leje, ose depozitim, ose njoftim të çdo autoriteti qeveritar apo rregulator sipas çdo klauzole të ligjit në fuqi apo rregulloreje;

NENI 6 **KUSHTE TË PËRGJITHSHME**

6.1 Palët bien dakord të rishikojnë mundësinë që për tre vitet e ardhshme financiare, në rast të realizimit ë një rezultati neto pozitiv, fitimet të mos shpërndahen në formë dividenti por të kapitalizohen.

6.2 Blerësi eshte dakord qe Shoqeria te administrohet nga z. Shkelqim Llagaci dhe e konfirmon administrimin e Shoqerise prej tij, në përputhje me nenin 95.3.a dhe 95.3.b të ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

NENI 7

NDALIMI I KONKURENCËS

7.1 Shitësi dhe Blerësi garantojnë se nuk do te bashkepunojne, direkt apo indirekt deri ne shkallen e trete, me klientet ekzistues te Shoqërisë "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k ne ofrimin e sherbimeve te njejta apo te ngjashme, nëpërmjet personave apo shoqerive të lidhura me të në menyre direkte apo indirekte. Veçanërisht Shitësi garanton Blerësin se Shoqëria "Autochtonous" sh.p.k apo organe të tjera drejtuese të Shoqërisë të kontrolluara nga Shitësi nuk do të bashkëpunojë direkt ose indirekt me klient ekzistues të Shoqërisë "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k.

7.2 Ky detyrim i Blerësit vlen edhe për rastet kur ai largohet nga Shoqëria "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k, për një afat 5 vjeçar nga data e largimit.

NENI 8

ZGJIDHJA E KONTRATËS DHE PASOJAT

Kjo kontratë për shit-blerjen e kuotave do të zgjidhet në rast të:

8.1 Mos plotësimit të detyrimeve të marra përsipër nga ndonjëra prej palëve, siç përcaktohet në nenin 2 të saj.

8.2 Mos plotësimit të detyrimeve të marra përsipër nga Shitësi, siç përcaktohet në nenet 3, 4 dhe 6 të saj.

8.3 Në rast se informacioni i dhënë në këtë kontratë sipas nenit 4 është i pavërtetë.

8.4 Në rastin e forcave madhore, në rastet e luftës e të trubullirave civile, në raste të shkatërrimit të pronës së shkaktuar nga tërmeti, shkatërrimi, kur këto fakte ndodhin para Datës së Transferimit.

Nëse vërtetohet mospërmbushja e deklarimeve të bëra në nenin 7 të kësaj kontrate Shitësi do të dëmshpérblejë Blerësin, dhe anasjelltas, me vlerën e fitimit që ky i fundit do të realizonte në cilësinë e ortakut të Shoqërisë "BLU COLOR SRL ALBANIA" sh.p.k nga veprimtaria tregtare e zhvilluar midis Shitësit apo personave të lidhur me të me personat e tretë sipas fitimit të deklaruar ne Bilancin e vitit 2019 nese ka dale ose 2018 nese viti fiscal 2019 nuk ka mbaruar.

NENI 9

LIGJI QË DO TË ZBATOHET

9.1 Ligji i zbatueshëm

Kjo Kontratë do të rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet e Shqipërisë. Ndonjë çështje e cila nuk është parashikuar në këtë kontratë do të rregullohet sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe parimet e përgjithshme të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë

9.2 Zgjidhja e Konflikteve

Ç'do mosmarrëveshje apo pretendim që mund të lindë në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate ose e lidhur me të, apo çdo shkelje që rrjedh prej këtej do t'i nënshtrohet zgjidhjes me mirëkuptim të palëve në këtë kontatë. Në rast se nuk do të arrihet zgjidhja me pajtim, Gjykata kompetente për zgjidhjen e konfliktit do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 10

TË NDRYSHME

10.1 Amendimet dhe Modifikimet

Kjo Kontratë mund të amendohet, ndryshohet dhe shtohet vetëm sipas marrëveshjes së shkruar të Palëve

10.2 Njoftimet

Gjithë njoftimet apo komunikimet e tjera që burojnë prej këtu, duhet të jenë në formë të shkruar dhe duhet të konsiderohen të dhëna efektivisht (i) përmes dërgimit jo në rrugë postare në qoftë se dorëzohen personalisht (ii) përmes dërgimit në rrugë postare në qoftë se dorëzohen nga korrieri ose (iii) përmes njoftimit të marrjes në qoftë se jepen me anë të telefaksit që konfirmohet me anë të postës rekomande.

Në cdo rast njoftimi ose dërgimi do të bëhet në adresat e mëposhtme:

Në qoftë se adresohet Shitësit:

Personi i Kontaktit: Z.Shkelqim Llagaci
Adresa: banesë private Lagjia 1 Kamzë,
e-mail: alba.american@gmail.com.

Në qoftë se adresohet Blerësit:

Personi i Kontaktit: Z.Hysen Ruka
Adresa: Rr. Pjeter Bogdani, nr. 13, Tirane
e-mail: hysen.ruka@gmail.com.



Për cdo ndyshim të adresave palët detyrohen të njoftojnë njëra tjetrën në kohë të përshtatshme.

10.3 Kontrata si e Tërë

Kjo Kontratë, së bashku me të gjitha anekset shoqëruese, përbëjnë Kontratën e tërë dhe mirëkuptimin e Palëve në lidhje me objektin e saj. Kjo kontratë përfshinë të gjitha marrëveshjet paraprake, verbale apo të shkruara, premtim dhe garancitë e dhëna nga palët, por gjithnjë duke patur fuqi ligjore mbi to.

Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj.

NENI 11

GJUHA DHE KOPJET E KONTRATËS

Kjo Kontratë është përgatitur në gjuhën Shqipe dhe përbëhet nga 8 faqe dhe është hartuar në 4 (kater) kopje originale.

Une, Noteri, pasi ua lexova Paleve me ze te larte e te qarte kete Kontrate, konstatoj se Palet e gjejne te rregullt e ne perputhje me vullnetin e tyre te lire e te plotë, te shprehur perpara meje, e nenshkruajne ne pranine time pa verejtje dhe une e vertetoj sipas ligjit.

PALËT E KONTRATËS

SHITËSI

Z. Shkëlqim LLagaci

BLERËSI

Shoqëria "Bindi" sh.p.k

Përfaqësuar nga administratori

Z.Hysen Ruka

NOTER
Julian Zhelegu



INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK

rëndësi kanë vlerat

Formular Urdhër Transferte Transfer Order Form

Nr. i Ref. i Bankës: 001TT00024471

Banka Bank	International Commercial Bank	Dega Branch	Dede Gjo Luli	Datë* Date	0 8 / 0 5 / 2 0 1 9
<input type="checkbox"/> Brenda Bankës Within Bank	<input checked="" type="checkbox"/> Brenda Vendit National	<input type="checkbox"/> Jashtë Vendit International		<input checked="" type="checkbox"/> Normale* Normal	<input type="checkbox"/> Urgjente* Urgent
IBAN* (Klienti Urdhërues) IBAN (Ordering Customer)					
A L 7 2 2 0 7 1 1 0 3 2 0 0 0 0 0 3 0 3 0 0 4 6 6 2 0 1					
Klienti Urdhërues Ordering Customer					
BINDI SH.P.K.					
Adresa (Klienti Urdhërues) Address (Ordering Customer)					
RR.VASO PASHA NDERTESA NO.8 K.4 AP.10 TIRANE					
Burimi i fondave Source of funds					
BIZNESI					
Shuma (shifra / hale) Amount (figures / words)					
1 3 0 0 0 0 . 0 0					
NJEQIND E TRIDHJETE MIJE					
Monedha* Currency EUR					
Kursi i Këmbimit* Exchange Rate 0.00					

Komisionet Bankare* Details of Charges	<input checked="" type="checkbox"/> SHA	<input type="checkbox"/> OUR	<input type="checkbox"/> BEN
Gjithsecili paguan komisionet e veta Each client pays his own commissions			
Komisionet të paguhen nga klienti urdhërues Commissions to be paid by the ordering customer			
Komisionet të paguhen nga klienti përfitues Commissions to be paid by the beneficiary customer			

Komisionet* Commissions	200.00	Datë Valuta* Value Date	1 0 / 0 5 / 2 0 1 9
Kodi SWIFT* SWIFT Code	SGSBALTX		
Té dhënat e bankës përfituese, informacion shtesë (emri i bankës, banka ndërmjetëse, et...) Beneficiary Bank Data, additional information (Bank name, Intermediary Bank, etc.)	RAIFFEISEN BANK SHA		
Nr. llog./IBAN (Klienti përfitues)* Acc. No./IBAN (Beneficiary Customer)	A L 6 1 2 0 2 5 9 0 0 0 0 0 0 0 0 0 0 0 3 4 5 0 4 7 7		
Klienti përfitues* Beneficiary Customer	SHKELQIM LLAGACI	Shteti Country	Albania
Adresa (Klienti përfitues) Address (Beneficiary Customer)	TIRANE		
Qëllimi i Pagesës Remittance Information	KALIM FONDI PER SHITBLERJE KUOTAVE SIPAS KONTRATES NR.2088 REP NR.692 KOL DT.04/03/2019		
Kodi i Pagesës Payment Code	914.3AA110 Blerje kuota kapitali në kompani në Shqipëri		
Informacion Shtesë Additional Information	KALIM FONDI PER SHITBLERJE KUOTAVE SIPAS KONTRATES NR.2088 REP NR.692 KOL DT.04/03/2019		

Deklaroj se kam lexuar dhe jam dakort me deklaratat në faqen e pasme të këtij formulari.
I declare that I have read and I agree with the declarations in the backside of this form.

Emr Mbiemr i Klientit Urdhërues* / Name Surname Ordering Customer
Vula e Kompanisë* / Stamp of the Company

Nënskrimit punonjësit te Bankës* / Signature of the Bank Employee
Vula e Bankës* / Stamp of the Bank

Nënskrimet nga Zyrat Qendrore* / Back Office Signatures

Nënskrimet e SWIFT* / SWIFT Signatures



Banka nuk mban përgjegjësi përvonesa, mosekzekutim të transfertës kthim mbrapsht të transfertës apo pasoja tjera të shkaktuara nga pasaktësi në instruksionin e klientit.

Nëqoftëse monedha e transfertës nuk përfshihet në Listën e Bankave Korrespondente, Banka nuk mban përgjegjësi përdryshimet në shumën e instruktuar për shkak të aplikimit të kushteve të ndryshme të konvertimit nga Bankat Korrespondente.

Deklaroj(më) se:

Jam (jemi) njohur dhe kam (kemi) pranuar Kushtet e Punës së Bankës dhe aplikimin e komisioneve përkatëse sipas Kushteve në fuqi për kryerjen e transfertës sipas këtij instruksioni.

Informacioni i dhënë nga unë (ne) në këtë formular është i saktë dhe i vërtetë.

Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullues në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, fondet e transferuara me këtë urdhër pagese burojnë nga aktivitetë të ligjshme dhe nuk përbëjnë veprim për pastrimin e parasë ose financimin e terrorizmit.

Bazuar në ligjin në fuqi dhe në kuadrin rregullues për mbrojtjen e të dhënavë personale, jap(im) pëlqimin tim (tonë), përpunimin e të dhënavë personale të mia (tona) nga Banka dhe sipas rastit, të transferimit ndërkombëtar të tyre.

Dokumentacioni i paraqitur për kryerjen e kësaj transferte nuk është përdorur më parë për transferta të tjera, dhe është në përpunje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për veprimtarinë Valutore" dhe kuadrit rregulator e legjislativ në fuqi.

The Bank is not responsible for delays, non-execution return of funds, or any other consequences that may result from inaccurate instructions of the customer.

If this transfer currency is not included in SIs, the Bank does not bear any responsibility for any difference amount may occur due to different exchange rates applied from the correspondent banks.

I (We) declare that:

I (we) have read and accepted the Bank's Terms & Conditions and I agree to the application by the Bank of relevant commissions for the execution of the transfer as per this instruction.

The information I (we) have given in this form is correct and true.

Based on the legal and regulatory framework in force, on the prevention of money laundering and financing of terrorism, the funds transferred by this payment order have been obtained by legal activities and do not constitute action for money laundering or terrorism financing.

Based on the law and the regulatory framework in force on personal data protection, I (we) give my (our) consent for the processing of my (our) personal data by the Bank and, where appropriate, their international transfer.

The documentation submitted for performing this transfer has not been used previously for other transfers, and is in accordance with the regulation of Bank of Albania "On Foreign Exchange Activities" and the legal and regulatory framework in power.

values count



Registri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX: 355 4 2420005
TEL: 355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-201905071656780
Data e Rezultatit te Kerkimit: 07.05.2019
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 4:56:07PM
Lloji i Kerkimit: D-400-168-3134
Numri i Dokumentit:
Referencia e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

SHKELQIM ISMAIL LLAGACI
BLU COLOR SRL ALBANIA SH.P.K.





Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

FATURË

Emri i Perdoruesit: JULIAN
XHAFER
ZHELEGU

Adresa: TIRANE
TIRANE-TIRANE
SHQIPERI

Nr. i Llogarise: 400-168

Date: 07.05.2019

Pershkrimi: D-201905071656780

Balanca Perpara: Leke 9,300.00

Debi Leke 1,900.00

Balanca Aktuale: Leke 7,400.00

Koment:

